


# BESNIK MUSTAFAJ

## MOTIVE TË GËZUARA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
M 9.8



Vjersha


814-1

198

BESNIK  
MUSTAFAJ

# Motive Të gëzuara

vjersha



13793

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRARY  
CARATHEUM

Wolfe  
Le Gesneria

politeja



Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re Tiranë, 1978

## P E R N E N E N

Kam muaj pa tē parë, e shtrenjta ime, e urta.  
Të puthurat e tua tē fundit, kur më përcole,  
përditë m'i gicilojnë faqet, ballin, buzët.

Përditë lumi i mallit për ty  
më rrjedh më i fryrë në zemër.  
Malli për ty, në qënien time,  
më tē rëndë se çdo gjë e ka peshën.

Tani kur i përkulur mbi librat e shkollës jam a mbi  
ndonjë vjershë,  
më del para sysht ftyra jote  
me tē qeshurën e vegantë që ka nëna për birin në  
buzë.

Rrudhat e ballit e thinjat duket sikur m'i  
përsërisin  
fjalët që më the, kur u nisa:  
— Ardhsh i bardhë!  
Dy fjalë me dëshirën e zemrës  
brenda.

## MBRÖMJA E FUNDIT

Dhamë dhe provimin e fundit të maturës.  
Nesër në karvane të gëzueshme  
do të na shohin të udhëtojmë drejt hekurudhës.  
(Sapo i hekurosëm pantallonat, shamitë e kaltra e  
bluzat.)

Kjo është natë e fundit konviktore, që na mbledh  
në dhomën tonë nr. 26.  
Mbi tavolinë janë akoma librat e shkollës,

si përshtendetja e fundit e një kohe që s'do ta takojmë më kurër.

I marrim ngadalë, hapim kapakët e tyre me mall, sikur takohemi prapë me gjithë ato ditë të bukura, me shqetësimet e gëzimet e tyre të shumta.

## MALET ME BLERIM MBULUAR

Me gunën e blerimit tuaj  
u mbështollëm,  
kur hasmi na i dogji të mbjellat.

Në degët e rrënjët e blerimit tuaj  
varëm jetën,  
kur na i prishën të mbjellat.

Male shqiptare,  
me blerimin e jetës mbuluar,  
nëpër shekuj,  
istikamet tuaja të gurta  
vendlindjet e vendvdekjet tonë të  
përherëshme.

Sot  
nëpër trajtat shkëmbore të fytyrës  
suaj të mrrolur,

pranë pozicioneve të zjarrit,  
pranë minierave, rrugëve  
automobilistike,  
pranë pemëve frutorë të tarracave,  
nëpër kullota, nëpër parqet e  
qytezave të sharrëxhinjve  
hapim toka të reja,  
dhe vigjilojmë.

## BALADA E FËMINISË

Tek po më puthte, për të më pushuar  
vajin,  
nënën ma vranë.

Qumështi i buzëve e lotët e syve  
ma mbuluan fytyrën,  
m'i mbushën grushtet,  
nënës ia derdha mbi plagë,  
po gjaku s'iu ndal.

Ma vranë nënën këmishëzinjtë.  
Flakë e syve iu rrit në sytë e mi,  
zemra e saj hyri në gjoksin tim.

Gjak i asaj zemre në shpirt e në deje  
më rrjedh, shkumëzohet e oshëtin si  
lumë.

Urrejtja për të gjithë armiqtë  
përherë në rritje pa njohur gjumë.

## MJESHTRI PLAK I URAVE

Ecën ngadalë mbi urën që ka ndërtuar vetë.

Nëpër rrudhat e ballit  
sikur i rrjedhin tërë lumenjtë e vjetër e të rinj,  
që brigjet ua lidhi me krahë të hekurt.

Gishterintjtë i janë holluar e forcuar si ganxha,  
shpatullat formën e harqeve të urave i kanë marrë,  
nëpër to erozion i ujërave të viteve thyhet.

Në kokë flokët të bardhë, të bardhë,  
a thua se i ka mbështjellë shkuma e stërkalave.

FYELLI

Gjashtë të çarat e tij  
gjashtë gryka malesh,  
ku rrjedhin gjashtë lumenj gjaku  
të rënësh  
nëpër shtratin e këngëve të trimërisë.

Gjashtë dritaret e tij  
gjashtë zemra vajzash,  
ku buzëqeshin  
gjashtë djem të bukur punëtorë.